



Pas vaksinës tuaj COVID-19 nga Moderna

Ju falënderojmë që po e mbroni veten tuaj dhe të tjerët duke e bërë vaksinën. Tani që e keni bërë vaksinën, ju lutemi të lexoni me vëmendje këtë dokument, në mënyrë që të dini se çfarë të prisni dhe si do të ndiheni ditët e ardhshme, dhe ku mund të merrni më shumë informacione.

Lexoni edhe fletëpalosjen të cilën ua kemi dhënë me informacione për vaksinën COVID-19. Gjithashtu, po ju japim një kartelë si provë të vaksinimit tuaj sot.

Ju lutemi ruajeni kartelën e vaksinimit në mënyrë të sigurt.

Çfarë mund të ndodhë në ditët në vijim?

Disa persona që kanë bërë vaksinën që e keni bërë ju sot:

- do të kenë ndjeshmëri, fryrje, skuqje dhe/ose kruarje në pjesën e krahut ku i është dhënë injeksioni i vaksinës
- do të ndjehen të lodhur
- do të kenë dhimbje koke
- do i fryhen gjëndrat limfatike poshtë krahut ku i është bërë injeksioni
- do të kenë dhimbje të muskujve
- do të kenë dhimbje të nyjeve
- do të kenë të përziera ose të vjella
- do të kenë temperaturë (temperaturë e lartë prej 38 gradë Celsius ose më lartë)

Siç është rasti me të gjitha vaksinat, mund të raportoni efektet anësore të dyshuara tek Autoriteti Rregullator i Produkteve Shëndetësore (HPRA) Për të raportuar efektet anësore nga një vaksinë COVID-19, ju lutemi vizitoni

www.hpra.ie/report

Çfarë të bëj nëse kam temperaturë ose dhimbje?

Nëse keni temperaturë ose dhimbje, mund të merrni paracetamol ose ibuprofen për t'ju ndihmuar. Megjithatë, nëse temperatura vazhdon të jetë e lartë për më shumë se 48 orë ose nëse keni akoma shqetësime, ju lutemi të kërkonit këshillën e mjekut. Mos merrni ibuprofen nëse jeni shtatzënë.

A duhet të bëj diçka përpara se të marr dozën e dytë të vaksinës?

Kur t'ju administrohet doza e ardhshme dhe e fundit e vaksinës, ju lutemi të njoftoni ekipin e vaksinimit nëse keni pasur ndryshime në historinë tuaj mjeksore.

Merrni me vete kartelën e vaksinimit kur të shkoni ta merrni dozën e dytë

Kjo do të ndodhë pas 28 ditësh (katër javë).

Lajmet e mira

Administrimi i një vaksine COVID-19 duhet të ju mbrojë nga ndërlikimet që mund të shkaktojë COVID-19.

Vaksina mëson sistemin imunitar të mbrohet nga sëmundja. Është shumë më e sigurtë që sistemi imunitar ta mësojë këtë nëpërmjet vaksinës sesa duke u infektuar me COVID-19.

Akoma jemi duke mësuar

Për të pasur efekt, nevojiten 14 ditë pas marrjes së dozës së dytë.

Ekziston një mundësi e vogël që të infektoheni në vazhdim me COVID-19, edhe pse keni bërë vaksinën. Nuk e dijmë akoma nëse vaksina do të pengojë përhapjen e virusit tek personat tjerë, andaj duhet të vazhdoni të respektoni rekomandimet e shëndetit publik:

- respektoni udhëzimet në lidhje me distancimin social (mbani një distancë pre 2 metrave nga të tjerët, nëse është e mundur)
- mbuloni fytyrën
- lani duart rregullisht.

Keni pyetje?

Nëse nuk jeni i/e sigurt për ndonjë gjë ose keni pyetje në lidhje me vaksinën COVID-19, ju lutemi bëjani këto pyetje sot personit që ju bën vaksinën.

Vizitoni www.hse.ie/covid19vaccine për më shumë informacione për vaksinën COVID-19.

Efektet anësore

Ju lutemi të raportoni çdo efekt anësor tek HPRA në www.hpra.ie/report

Publikuar nga HSE më 2 Shkurt 2021.

Versioni 2.



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland